



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.22/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit N.T.SH. “U...” me seli në Kamenicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatos Zeqiri Avokat, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti – vlerësim tatimor, vlerë kontesti 5,959.37 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Avokat Fatos Zeqiri dhe në mungesë të palës së paditur, me datës 20.09.2022, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.SH. “U...” me seli në Kamenicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatos Zeqiri Avokat, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Vendimi nr. 259/2019 i datës 06.08.2019, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 13.09.2019, dhe të plotësuar me parashtrësën e datës 14.02.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 259/2019 i datës 06.08.2019, për shkak se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat materiale të ligjit për administratën tatimore, ligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe udhëzimit administrativ 01/2016

për zbatimin e ligjit për tatimin në të ardhurat personale. Në seancë e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: kërkoj nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë dhe vendimin e atakuar ta anulojë në tërësi si të kundërligjshmen për shkak se i njëjti është nxjerrë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, konkretisht nenit 13të Ligjit për Trajtimin e të Ardhurave Personale, si dhe nenit 19 të Udhëzimit për zbatimin e të njëjtit Ligj. Duhet të potencojmë se paditësi në vitin 2014 ka bërë kërkesë për transferimin e biznesit nga NTSH Uniteti në Uniteti sh.p.k, e cila kërkesë është aprovuar nga Administrata Tatimore e Kosovës në vitin 2019, me rastin e paraqitjes së kërkesës për mbyllje-çregjistrim të biznesit NTSH Uniteti, ATK-ja ka hapur kontroll me qëllim të verifikimit nëse biznesi ka qarkulluar në këtë periudhë dhe ka zhvilluar aktivitet biznesor. Gjatë kontrollës përveç llogarisë së NTSH U..., janë kontrolluar edhe llogaritë e Ortakëve të Përgjithshëm, dhe në rastin konkret janë vërejtur edhe dy shuma në formë të huazimeve për Ortakun Z.I të pranuar nga C... sh.p.k, dhe M.M. Që të dy transferet janë bërë në llogaritë private, dhe të njëjtat huazime janë kthyer sërish tek huadhënësit përmes transfereve. ATK-ja gabimisht ka bërë vërtetimin e gjendjes faktike ku i referohet që njëri nga transferet është bërë në mes të ortakëve. Ky pretendim i tyre nuk qëndron, për shkak që ashtu siç vërehet përmes llogarive bankare të njëjtat huazime janë kthyer tek huadhënësit, dhe gjykatës në cilësi të provës i'a ofrojmë edhe një Konfirmim nga NLB BANKA, se transferi në shumën 10,725.00 €, është pranuar dhe kthyer tek C..., kurse transferi në shumën 9,961.00 €, është pranuar dhe kthyer tek M.M. Inspektori i rastit edhe përkundër që i ka pasur këto prova, shumën e huas e ka konsideruar si të hyrë reale dhe paditësin e ka ngarkuar me tatim shtesë në vlerën totale prej 4,899.99 € për tatimin e vlerës së shtuar, duke përfshirë këtu edhe ndëshkimet dhe interesat. Kurse Ortakët e Përgjithshëm të paditësit i ka ngarkuar me nga 529.69 €, në emër të tatimit mbi të ardhurat individuale. Duke pasur parasysh që neni 13 i Ligjit për të Ardhurat Personale parasheh të ardhurat nga interesi, në rastin konkret kemi të bëjmë me zbatim të gabuar të kësaj dispozite, për shkak se paditësi nuk ka qenë në cilësinë e huadhënësit mirëpo huamarrësit, dhe nuk ka pasur interes nga huaja. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 10.11.2020, kundërshton pretendimet e paditësit dhe konstaton se vendimi kontestues është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm, dhe i propozon gjykatës që të merr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tersi si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të vërtetohet si i bazuar vendimi kontestues. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, por me parashtrësën e datës 12.09.2022 e ka arsyetuar mungesën, andaj gjykata ka vepruar në pajtim me nenin 41, të LKA-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat dhe atë: Njoftimet për Transfer të Biznesit nr. ..., nr. ..., Qarkullimi për Llogari në NLB Bankë për klientin Z.I për periudhën 01.01.2014 deri 03.09.2019, Qarkullimi për Llogari në NLB Bankë për klientin NTSH U... për periudhën 01.01.2014 deri 03.09.2019, Vendimi 259/2019 i datës 06.08.2019, Përgjigja në Padi e datës 10.11.2020, Kontratat mbi Huazimin të datës 24.01.2018, 15.12.2014 dhe 23.05.2017, Gjendja e Përgjithshme e Deklarimeve dhe Transaksioneve të Tjera së bashku me Tabelën Borxhi i Falur i datës së printimit 11.06.2020, Ankesa e ushtruar në ATK e datës 11.06.2019, Ekstrakti i Transaksionit të datës 06.06.2019 për pronarin Z.I, Faturat ...- e, F- ..., F- ..., Detajet e Vlerësimit nga ATK për periudhën 08.2015, Kartela e Qarkullimit nga NLB Bankë për NTSH UNITETI për periudhën 29.11.2013 deri 29.10.2014, Raporti mbi Kontrollin i datës 15.05.2019, Konfirmimi i Pagesës së Pranuar nga NLB Banka për Z.I pa numër dhe datë.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor Kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se i padituri ka ushtruar kontroll tek këtu paditësi dhe me datë 15.05.2019 ka përpiluar raportin e kontrollit, e i cili raport për periudhën e kontrollit 2017 dhe 2018 janë konstatuar ndryshime në llojin e tatimit TVSH-ë. Tutje nuk është kontestues as fakti se këtu paditësi me datë 11.06.2019 ka ushtruar ankesë në ATK-ë ndaj raportit të kontrollit të datës 15.05.2019 e për të cilën ankesë këtu e paditura me datë 06.08.2019 ka sjell vendimin nr. 259/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 13.09.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, dhe raporti i kontrollit i datës 15.05.2019, Gjykata ka gjetur se subjekti tatimor këtu paditësi ka pasur statusin e ortakërisë së përgjithshme andaj bazuar edhe në ligjin për shoqëritë tregtare në Kosovë, Ortakët e Përgjithshëm janë individualisht dhe kolektivisht përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera kontraktuese ose ligjore të Ortakërisë së Përgjithshme. Kjo përgjegjësi është e pakufizuar dhe përfshin të gjithë pasurinë dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një Ortaku të Përgjithshëm. Nisur nga kjo si më lartë nuk qëndron pretendimi i këtu paditësit se transferet e realizuara nga ose ndërmjet ortakëve të përgjithshëm në llogaritë e tyre personale bankare nuk duhet të merren në konsideratë gjatë ushtrimit të kontrollit ndaj subjektit N.T.SH. “U...” me seli në Kamenicë, ngase përgjegjësia e ortakëve të përgjithshëm është e pakufizuar dhe përfshin të gjithë pasurinë dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tyre.

Gjykata nga kontrata e datës 23.05.2017 ka gjetur se e njëjta është e lidhur ndërmjet Sh.I si dhënëni i huazimit dhe Z.I si marrës i huazimit për shumën prej 10,725.00 euro, dhe me afat të pa caktuar, e që të dy këta sipas këtyre kontratave janë vëllezër ndërsa sipas të dhënave nga raporti i kontrollit të datës 15.05.2019 ishin edhe ortak të përgjithshëm të subjektit N.T.SH. “U...” me seli në Kamenicë. Tutje lidhur me këtë transaksion gjykata

ka gjetur si kundërthënës deklarin e të autorizuarit të këtu paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor i cili përveç tjerash deponon edhe konfirmimin e bankës NLB se transferi në shumën si më lartë është pranuar dhe kthyer tek subjekti C..., e nga i cili transfer gjykata konstaton vetëm kreditimin për njërin nga ortakët e përgjithshëm në këtë rast të Z.I të shumës si më lartë nga dërguesi C..., por jo edhe kthimin e të njëjtës shumë, ndërsa lidhur me kontratën e datës 23.05.2017, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se *‘unë nuk e kam parë këtë kontratë dhe nuk mund të deklarohe lidhur me të njëjtën, mirëpo në bazë të transaksionit shihet që është shuma e njëjtë, por huadhënësi është i ndryshëm’*, Gjykata, kontratën e datës 23.05.2017, të lidhur ndërmjet Sh.I, dhe Z.I për shumën prej 10,725.00 €, si huazim në afat të pa caktuar i’a jep përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse në shikim në seancë mirëpo përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse deklaron: *‘Nuk kam diçka për të shtuar, përveç asaj si më lartë’*. Për më tepër dispozita nga neni 2, par 1.16 i ligjit 05/L-028, shprehimisht përcakton se : *‘ Personat e lidhur janë persona me lidhje të veçanta që mund të ndikojnë materialisht në rezultatet ekonomike të transaksioneve ndërmjet tyre. Personat konsiderohen se kanë lidhje të veçantë nëse: janë partnerë të ligjshëm në biznes’* .

Gjykata nga kontrata e datës 24.01.2018 ka gjetur se e njëjta është e lidhur ndërmjet Meriton Maliqit si dhënësi i huazimit dhe Z.I si marrësi i huazimit për shumën prej 9,961.00 euro, e ku ki i fundit sipas të dhënave nga raporti i kontrollit të datës 15.05.2019 ishte edhe ortak i përgjithshëm te subjekti N.T.SH. “U...” me seli në Kamenicë, dhe e cila kontratë nuk e ka të përcaktuar afatin e kthimit të huazimit dhe as interesin e përcaktuar andaj si e tillë nuk i plotëson as kushtet ligjore për tu trajtuar ndryshe përveç si e hyrë nga deponimi, kjo ngase sipas nenit 19, par 1, nën par 1.1 të Udhëzimit Administrativ 01/2016, për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 05/L028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, decidivisht është përcaktuar se kontrata në mes palëve duhet të përmbaj, Shumën e huas; Afatin e kthimit të huas; Pranimin-kthimin e huas duhet të bëhet përmes llogarive bankare, dhe Shkallën e interesit të huas duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut, dhe sipas këtij neni thuhet se nëse nuk plotësohen kushtet e parapara si më lartë, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj, e që sipas kontratës së

datës 24.01.2018, gjykata ka konstatuar se pranues i huas është Z.I i cili njëherit ishte edhe njëri nga ortakët e përgjithshëm në subjektin N.T.SH. “U...”, këtu paditësi.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi, plotësim të padiisë dhe në seancë sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Nuk mjafton që paditësi pretendimet lidhur me huazimet e datës 23.05.2017 dhe 24.01.2018, vetëm ti cek si të tilla në padi dhe plotësim të padiisë por pa i mbështetur me fakte dhe prova konkrete, sepse gjykata vepron vetëm në bazë të fakteve dhe provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe me të drejtë i padituri konform gjendjes faktike të konstatuar në procedurë administrative me raport të kontrollit të datës 15.05.2019, të dispozitave si më lartë, dhe në mungesë të fakteve dhe provave ka refuzuar kërkesën e tatimpaguesit këtu paditësit, dhe deponimet në shumat prej 9,961.00 euro dhe 10,725.00 euro i ka trajtuar si të hyra.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë konflikt administrativ.

Neni 43, par 1. i LKA-së, *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*, andaj paditësi në këtë konflikt

administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thënie e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.22/22 datë 20.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

---

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

---

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.